



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 936, datë 25.11.2020

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.587, DATË 22.7.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE
TË BANIMIT NË NDËRTEZA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT
E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pikat 2 dhe 3, të vendimit nr.587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:
 2. Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 1 671 284 846 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësisve të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.
 3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 1 671 284 846 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekësh pa TVSH."

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ